



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A:	26. 12. 2018 02-104/02-40779/18
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSELI, kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	
NGA/OD/FROM :	Ramadush OSMANI, drejtor i DSHPE-së
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Informatë rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë Informatën rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut, të kërkuar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të dt. 21.12.2019, si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës së kuvendit komunal.

Me respekt,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 26. 12. 2018

Për: Anëtarët e Kuvendit:

Informatë

Të nderuar,

Më lejoni t'ju informoj dhe jap sqarime lidhur me kërkesën e anëtarit të kuvendit komunal Nexhat Loku, të parashtruar para Komitetit për Politikë dhe Financa, më datë 21. 12. 2018, lidhur me mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka të kontraktuar kompaninë "Eurotrans" sh.p.k , me seli në Doganaj-Kaçanik, për projektin "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut", kontratë njëvjeçare me nr. të kontratës **KA652/18/10/221 b** në vlerë 110,079.00, për periudhën kohore nga 30.05.2018-30.05.2019.

Menaxher për mbikëqyrjen e implementimit të kësaj kontrate është caktuar zyrtari komunal **Rakip Vishi**.

Pasi që kërkesa e anëtarit të kuvendit komunal Nexhat Loku ka të bëjë ekskluzivisht me mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale atëherë ne do ju informojmë më hollësisht rreth aktiviteteve të realizuara nga kjo kontratë për këtë periudhë kohore.

- Me përkeqësimin e kushteve atmosferike duke filluar nga dt. 29.11.2018 kompania është angazhuar në intervenim në fshatin Strazhë, hudhje e kripës industriale e kombinuar me sasi të zhavorit të imët në segmente të caktuara të rrugës të vlerësuara si më të rrezikshme.
- Poashtu me dt. 14.12.2018 është intervenuar në Dushkajë, hyrje e qytetit, rrugët në zonën urbane, dhe rruga "Avdurrahim Shehu"-Kaçanik si janë sanuar me kubëza betoni prerjet në rrugën Bob-Doganaj.
- Me dt.16,17 dhe 18.12.2018 prap është intervenuar në rrugën dhe është bërë hudhja kripë industriale në rrugët: Bob-Doganaj, Gajre -Ivajë, Doganaj, K.Vjetër ,Begracë,Dubravë, Biqec, Stagovë, Gjurgjedel, Kashan-Laç dhe Kotlinë
- Me dt.21.12.2018 është intervenuar duke hudhë kripë industriale në rrugën:"13 Dëshmorët"-Kotlinë.
- Me dt.25.12.2018, është intervenuar në rrugët e fshatit Kotlinë, Ivajë dhe Strazhë-hudhje kripës industriale kombinuar me rërë të imët.

Gjithashtu ju njoftojmë se në kuadër të planit operativ të drejtorisë rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale prioritet në mirëmbajtje kanë rrugët kryesore në zonën urbane të qytetit, rrugët primare të lagjeve të qytetit, gjitha rrugët kryesore të vendbanimeve rurale të komunës dhe rrugët që shpiejnë deri te objektet publike siç janë: shkollat, ambulancat, zyret e vendit, etj., kurse rrugët periferike të lagjeve të qytetit dhe fshatrave, intervenohet vetëm në rastet emergjente kur kemi të bëjmë me raste të sëmundjeve apo evidencës së personave që janë në terapi të vazhdueshme si; dializë apo ndonjë terapi tjetër .

Me respekt,

Ramadush Osmani

Drejtore i DSHPE-së

